



## Identiteti i Jezusit

### Description

**John P. Meier**

Fragmenti i shkëputur nga: "[New Jerome Biblical Commentary](#)", [The \(paperback reprint\) \(3rd Edition\)](#) by Raymond E. Brown, Joseph A. Fitzmyer, and Roland E. Murphy (Paperback – Nov 25, 1999)

### ***Problemi***

Qendra dhe fokusi i mesazhit dhe jetës ministrore të Jezusit ishte ardhja e Mbretërisë së Perëndisë, triumfi i Atit në mëshirë dhe gjykim dhe rimbledhja e popullit të Zotit në fundin e kohërave. Me fjalë të tjera Jezusi ishte krejtësisht i drejtuar për nga tjetri; ai nuk e bëri veten objekt direkt të thirrjes së tij. Jezusi kishte një teologji direkte (Zotin si objekt të predikimit të tij), gjë e cila përfshin një kristologji indirekte ose implicite (Jezusi si mjeti përfundimtar i Zotit). Kështu që identiteti i Jezusit ishte përthithur dhe përcaktuar nga misioni i tij. Ai nuk ka dhënë asnjë shenjë vuajtje nga ndonjë krizë identitare apo ndonjë shenjë nevojë të dëshpëruar për të përcaktuar vetveten. Duket se ai ka qenë krejtësisht i sigurt rreth identitetit të tij.

Fatkeqësisht, të gjithë të tjerët ishin të pasigurt për identitetin e tij. Siç dëshmohet nga gjithë Dhiata e Re, Jozof Flavi, shkrimet rabinike dhe literatura pagane, si miqtë ashtu edhe armiqtë e tij rrekeshin së koti për ta kuptuar Jezusin duke përdorur kategori dhe tituj të ndryshëm për të, por e gjitha kjo nuk dërgoi në rezultate plotësisht të kënaqshme. Arsyeja për një çoroditje të tillë qëndron në paradoksin themelor që paraqiste Jezusi. Ndonëse ai rrallëherë foli për statusin e tij, përsëri ai, në mënyrë implicite, e bëri veten figurën kryesore në dramën eskatologjike të cilën ai e predikoi dhe e përuroj. Ishte falë predikimeve dhe shërimeve të tij që Mbretëria e Perëndisë ishte bërë e pranishme madje që në kohën e Tij. Dëgjuesit e tij do të gjykoreshin në Ditën e Fundit për mënyrën e reagimit të tyre ndaj fjalëve të Jezusit gjatë momentit të marrjes së vendimit (Mateu 7: 24-27; Luka 9:26 dhe 12:8). Pavarësisht nga fakti nëse ka folur, apo jo, Jezusi për veten e tij si gjykatësi i Ditës së Fundit, gjithsesi ai ka folur dhe vepruar mbi supozimin se ai do të ishte kriteri i përdorur për Gjyqin Përfundimtar. Vetëm

ky fakt përfshin një pohim madhështor për një status dhe rol unik në kulim e historisë së Izraelit. Si ka aluduar, saktësisht, Jezusi për këtë rol – gjithnjë nëse e ka bërë me të vërtetë?

## Zoti si At

Shumë specialist theksojnë eksperiencën e Zotit si *Abba*, nga ana e Jezusit, si një mënyrë jetese dhe një nga burimet kryesore të mesazhit të tij (shih R. Hamerton-Kelly, *Concilium* 143 [3, 1981] 95-102; J. Jeremias, *Abba* [Göttingen, 1966] 15-67; Schillebeeckx, *Jesus* 256-271). Kjo qasje thekson faktin se Jezusi përjetonte një eksperiencë të thellë të Zotit, të parë si babai i tij. Ai guxonte ti drejtohej Zotit me shprehjen që tregon afërsi dhe nderim *Abba* (Babai im i dashur). Një shprehje religjioze kjo e cila, për aq sa ne dimë, ishte e panjohur e me shumë mundësi fyese për hebrenjtë e devotshëm të kohës së tij. Një fjalë e cila i drejtohej baballarëve njerëzore, nuk përdorej për Zotin gjatë liturgjisë në sinagogë. Jezusi, gjithashtu, i mësonte dishepujt të tij që të imitonin marrëdhënien e tij të afërt me Zotin të parë si *Abba*. Mësimi dhe praktika e Jezusit buronin pikërisht nga kjo siguri dhe mbështetje e plotë e Jezusit tek Zoti. Megjithatë, është e nevojshme që në këtë pikë të tregojmë maturi (shih Conzelmann, *Jesus* 49-50; J. A. Fitzmayer, në *À cause de l'Évangile* [Fest. J. Dupont; LD 123; Paris, 1985] 15-38). Disa pasazhe në të cilat Jezusi i është drejtuar Zotit me emrin "At" ka shumë mundësi që të jenë sekondare, siç sugjerohet nga krahasimi i pasazheve paralele dhe tendencave redaktuese (veçanërisht ato Mateut dhe Gjonit). Mbi të gjitha, në të katër ungjijtë termi *Abba* ndeshet vetëm tek Marku 14:36 (ku Jezusi është i vetëm!) dhe mund të shpjegohet si prapavështrim i një praktike të hershme krishtere (Galatasve 4:6; Romakëve 8:15). Sidoqoftë, përdorimi i imazhit të Atit nga Jezusi gëzon dëshmi të shumfishta (*multiple attestation*) (Marku, burimi Q, traditat e veçanta të Mateut dhe Lukës, si edhe Gjonit). Ky term përputhet më së miri me pjesën tjetër të praktikave dhe mësimëve të Jezusit. Lutja e Atit, që gjendet tek Luka 11: 4, është konsideruar zakonisht nga shkollarët biblik si tepër e afërt me mënyrën se si Jezusi i ka mësuar të luten dishepujt e tij. Termi i veçantë grek *ho patēr* (nom. plus def. art.) i përdorur si thirrje, me shumë mundësi reflekton formën e theksuar aramaike të termit *Abba* (kështu Marku 14:36). Mbi të gjitha, shprehje të cilat janë gjykuar si autentike në sfera të tjera (p.sh. Luka 22:29-30) e paraqesin Jezusin duke thënë "Ati im". Nën dritën e gjithë kësaj që sapo thamë, historia e traditës së termit "Abba", me shumë mundësi, vjen nga Jezusi historik për tek përdorimi i krishterë i termit që haset tek Pali, në vend që të jetë e anasjella. Përndryshe, nëse nuk do ta merrnin parasysh alternativën e sipërpërmendur, do të na duhej të shpiknim një tjetër origjinë për përdorimin e hershëm të krishterë të termit *Abba*. Sidoqoftë, do të ishte e urtësi nga ana jone nëse do të shmangnim pohimin se asnjë hebre nuk e ka përdorur termin *Abba* në lutjen ndaj Perëndisë. Ne nuk dimë pothuajse asgjë për devotshmërinë popullore personale të hebrenjve galileas aramaikishtfolës të shekullit të parë (e.r.). Për më tepër, një ngjashmëri e pjesshme me përdorimin e Jezusit [të termit *Abba*] mund të gjendet në një burim shumë më të vonshëm rabinik (shih. Vermes, *Jesus the Jew* 210-211). Si përfundim mund të themi se dikush është i justifikuar në pohimin sipas së cilit përdorimi i termit të çuditshëm *Abba*, nga ana e Jezusit, shpreh përvojën intime të Perëndisë si Atin e tij dhe se ky përdorim la gjurmë të përhershme tek dishepujt e tij. Kjo marrëdhënie e veçantë e Jezusit me Perëndinë të parë si At na jep konture më të qarta të këndvështrimit që Jezusi kishte për veten e tij. Gjithsesi, skica e personalitetit të Jezusit nuk duhet të mbështetet vetëm mbi këtë të dhënë.

## Kategoritë dhe titujt

A mund të jemi më specifik nëse e vendosim Jezusin në disa kategori religjioze të kohës së tij? A ka përdorur ai ndonjëherë kategori apo tituj të përcaktuara qartë për veten e tij? Nën frymën e skepticizmit, disa kritikë preferojnë të heqin dorë nga çështja e ndërlikuar e titujve, ose e analizojnë atë

në disa apendikse të shkurtra (Bornkamm, Jesus 226-31; Sanders, Jesus and Judaism 324), por të dhënat e gjera dhe të ndërlikuara nuk mund të mos merren parasysh kaq lehtë (për një vështrim të përgjithshëm shih, R. Leivestad ANRW II/25.1, 220-264). Gjëja e mrekullueshme është se Jezusi i shkon për shtat shumë kategorive, por asnjëra prej tyre, të marra veçmas, nuk i përshtat ekzaktësisht dhe plotësisht personalitetit të tij. Siç është shprehur edhe Schweizer-i (Jesus 13-51), Jezusi është “njeriu që nuk i përshtatet [plotësisht] asnjë formule”, ndonëse shumë formulime takohen mbi të. Duhet të mbajmë mend se pritshmëritë eskatologjike të hebrenjve të shekullit të parë ishin gjerësisht të ndryshme dhe se nuk ekzistonte asnjë përfytyrim normativ i instrumentit eskatologjik të Perëndisë. Madje, në disa grupe nuk ekzistonte një pritshmëri e tillë.

## 1. Profet

Deri në momentin e fundit të misionit të tij Jezusi veproi si profet. Siç ka dëshmuar edhe Jozef Flavi, Jezusi ishte i vetmi hebre palestinez që mori këtë rol gjatë kohës që jetoi. (Vermes, Jesus the Jew 86-102). Por ai shkoi më tej, ai veproi si një profet eskatologjik, i fuqizuar nga shpirti hyjnor për ti shpallur Izraelit shansin e tij të fundit për pendim. Ndonëse koncepti i profetit eskatologjik mund të mos ketë qenë i përhapur në Judaizmin e asaj kohe (R. Horseley, CBQ 47 [1985] 435-63), përsëri disa figura të tilla shfaqen në shkrimet e Kumranit dhe pandehen tek Gjoni 6:14. Për sa i përket emërtimit [profet], Jezusi i është referuar vetes si profet vetëm në mënyrë indirekte dhe veçanërisht në kontekst të mohimit (Marku 6:4; Luka 4:24; Gjoni 4:44; Luka 13:33; 13:34-35; 11:32). Meqenëse në atë kohë ishte gjithnjë e në rritje një lloj teologjie që kishte të bënte me profetët e mohuar dhe të martirizuar, përvetësimi implicit i rolit të profetit nga ana e Jezusit përmban rrjedhoja edhe për fatin e tij të mundshëm. Megjithatë, termi profet është një kategori e papërshtatshme për të shpjeguar plotësisht fenomenin e Jezusit (kështu edhe Smith, Magician 158-64).

## 2. Mesia

Emërtimi dhe përfytyrimi i Mesias është veçanërisht i vështirë për tu marrë në shqyrtim, duke qenë se nuk ka ekzistuar vetëm një koncept rreth asaj se çfarë duhet të ishte Mesia. Madje, disa pritshmëri eskatologjike hebraike e përjashtonin idenë e një Mesiu, etimologjikisht termi do të thotë “i vajosuri”. Në Dhiatën e Vjetër, priftërinjtë, mbretërit, ndonjëherë edhe profetët vajoseshin, kështu që termi Mesia nuk nënkupton domosdoshmërisht birin mbretëror të Davidit. Anëtarët e Kumranit prisnin njëkohësisht një Mesia priftëror nga Aroni, një Mesi mbretërorë të Izraelit si edhe një profet eskatologjik (Aprocrypha, 67: 114-117). Nëse Jezusi e ka parë veten e tij si profeti eskatologjik i vajosur nga Shpirti, siç ishte premtuar nga Isaia 61:1-3 (krahaso Luka 4:16-21; 7:22 dhe pasazhet paralele), atëherë në këtë kuptim ai mund të quhet Mesi: Mesiu profetik apo profeti Mesianik i fundit të kohërave. Nuk ka asnjë provë se Jezusi është quajtur në mënyrë të drejtpërdrejt Mesi në kuptimin mbretëror të fjalës, siç nuk gjendet, gjithashtu, asnjë provë që ai ta ketë mohuar qartësisht apo kategorikisht këtë titull. Kur Pjetri e quajti Mesi Jezusin (Marku 8:29; Luka 9:20; ballafaqo Mateun 16:16-19), ky i fundit reagoi me ngurrim të madh (ngjarje e ruajtur madje edhe tek Mateu 16:20). Ndonjëherë të huajit mund të kenë folur për të si “Biri i Davidit” (Marku 10:47-48), por Jezusi nuk e mori në mënyrë të drejtpërdrejt mbi vete këtë titull (Krahaso, gjithsesi, referimin implicit tek Marku 12: 35-37 dhe pasazhet paralele.). Pavarësisht nga ngurrimi i Jezusit, duket se dishepujt e tij, madje që gjatë jetës së tij, e kanë perceptuar mësuesin e tyre, në një farë mënyre, si Mesia mbretërorë. Përndryshe, identifikimi i hershëm i Jezusit, menjëherë pas ringjalljes, si Mesia i ardhur nga fara e Davidit, i kurorëzuar gjatë ringjalljes, nuk do të kishte kuptim (Romakëve 1:3-4; Veprat 2:36; 2 Timoteu 2:8). Të thuash se ringjallja solli si pasojë që dishepujt e Jezusit ta quanin atë Mesia Davidik nuk shpjegon asgjë,

megenëse në atë kohë nuk ekzistonte asnjë besim hebraik rreth ndonjë Mesie nga fara e Davidit i cili duhej të vdiste dhe të ringjallej brenda historisë njerëzore. Ringjallja mund të ketë shërbyer vetëm si katalizator dhe mund të interpretohej si kurorëzimi i Birit të Davidit vetëm nëse dishepujt do të kishin ushqyer paraprakisht në mendje ndonjë ide rreth Jezusit si Mesia nga fara e Davidit. Që pohimet dhe veprimet e Jezusit janë interpretuar, gjatë jetës së tij, në një lloj kuptimi mesianik mbretërorë madje edhe nga vetë armiqtë e tij duket se konfirmohet nga akuza me të cilën ai u dërgua tek Pilati: të qenurit “Mbret i Judenjve” (shih N. A. Dahl, *The Crucified Messiah and Other Essays* [Minneapolis, 1974]).

### 3. Biri ose Biri i Perëndisë

Mundësia që Jezusi të ketë folur për veten e tij si Biri apo Biri i Perëndisë, në një lloj konteksti mesianik apo eskatologjik është refuzuar kategorikisht, duke pohuar që termi Bir i Perëndisë nuk ka qenë një titull mesianik gjatë kohës së Jezusit. Kjo mund të jetë kështu, por fragmenti 4QpsDan Aa nga Kumrani flet, në një kontekst eskatologjik, për një figurë mbretërore të misterhme si Biri i Perëndisë dhe Biri i Shumë të Lartit (krahaso Luka 1:32, 35; J. Fitzmyer, *JBL* 99 [1980] 14-15). Megjithatë shumë pak fjalë ku përdoret termi Bir ka gjasa që të shkojnë deri tek Jezusi historik. Pasazhi i Markut 13:32 duhet të na bëjë të reflektojmë e të ndalojmë pak. Ka pak gjasa që Kisha të ketë krijuar një thënie e cila thekson paditurinë e Zotit të saj të ringjallur rreth kohës së ardhjes së tij të dytë dhe as nuk është e mundur që Kisha të ketë ndërshtirë titullin e glorifikuar “Bir” në një thënie autentike të Jezusit e cila thekson paditurinë e tij. Përsëri, çështja nuk është plotësisht e qartë sepse Kisha mund ta ketë vendosur këtë titull për hir të kompensimit, për të balancuar pohimin e paditurisë. Sidoqoftë zgjidhja më e lehtë e këtij problemi do të kishte qenë fshirja e kësaj shprehje të sikletshme. Futja e titullit “Bir” kundrejt titullit “At” vetëm sa do ta kishte përkeqësuar problemin. Nën dritën e përdorimit të termit Abba, nga ana e Jezusit, për t’iu referuar Perëndisë, mundet që Jezusi ndonjëherë ti jetë drejtuar vetes me të drejtë si “Biri”, duke ju referuar pikërisht përmbushjes së ardhshme.

Kandidat i dytë për një shprehje autentike ku është përdorur termi Bir është edhe parabola e vreshtit dhe vreshtarëve të ligë (Marku 12:1-12 dhe pasazhet paralele). Paçka se kjo parabolë ka pësuar redaktime të bollshme, përsëri janë të dallueshme konturet e një parabole e cila mbaron thjesht me vdekjen e birit, duke mos iu referuar asnjë ndryshim vendesh, hakmarrjeje, apo ringjalljeje (kështu J. Jeremias, *The Parables of Jesus* [London, 1963] 72-73). Kjo parabolë do të ishte një shpikje e çuditshme nëse do të kishte për autor Kishën pas ringjalljes së Jezusit, por ajo është krejtësisht e kuptueshme në gojën e Jezusit [historik] gjatë kohës që ai përplasej për herë të fundit me rivalët e tij në Jeruzalem. Biri i parabolës është shumë në përputhje me linjën e profetëve të refuzuar dhe të martirizuar, kështu që mesazhi i saj përputhet mjeshtërisht me këndvështrimin e Jezusit për veten e tij si një profet eskatologjik. Ideja se Biri është i fundit në linjën e profetëve shërben për të na kujtuar ne, se nëse Jezusi e ka përdorur termin “Bir” për veten e tij, ai duhet parë një kuptim funksional, historiko-shpëtues dhe jo në kuptimin ontologjik të skalitur nga polemikat e mëvonshme patristike. Madje, Geza Vermes (*Jesus the Jew* 192-222) e sheh si të mundshme që Jezusi të jetë quajtur Bir i Perëndisë gjatë jetës së tij në një “kuptim hebraik” (d.m.th. njeri i devotshëm mrekullibërës dhe ekzorcist). M. Hengel (*The Son of God* [Phl, 1976] e refuzon fuqimisht idenë që ky titull të ketë ardhur në Krishterim nga fetë pagane.

Një pasazh i tretë, por shumë i diskutueshëm rreth vërtetësisë së përmbajtjes së tij është edhe ai tek Mateu 11:27 dhe pasazhet e tjera paralele me të. Në këtë pasazh Jezusi pretendon dije të përbashkët dhe të veçantë midis tij, Birit, dhe Atit. Lidhja e motiveve të urtësisë dhe atyre apokaliptike në këtë verset nuk janë të pamundurura dhe janë të kuptueshme për Jezusin, i cili e paraqet e veten e tij, në

këtë verset, më shumë si një ndërmjetës se sa si përmbajtje e revelatës. Kjo thënie është ruajtur në burimin Q, por ky burim nuk flet gjithnjë për Jezusin të konceptuar si “Bir”. Në të vërtetë, ky përdorim absolut (“Biri” i kundërvënë ndaj termit “Biri im” apo “Biri i Perëndisë”) haset vetëm në tre raste të veçuara (Mateu 11:27 dhe pasazhet paralele; Marku 13:32 dhe pasazhet paralele; Mateu 28:19). Mbi të gjitha ky përdorim tregon më shumë për në drejtim të termit Biri i njeriut se sa në atë të Birit të Perëndisë. Megjithëkëtë, sipas këndvështrimit të shumë kritikëve, përmbajtja ideore e Mateut 11:27, i ngjashëm siç është me Mateun 16:17-19, përputhet më shumë me situatën e Kishës pas ringjalljes së Jezusit se sa me Jezusin historik.

#### 4. Biri i njeriut

Titulli (ose përcaktimi) më shumë i diskutuar dhe më pështjellues që i është aplikuar Jezusit është ai i Birit të njeriut (në aramaikisht, bar (‘e) n?š?’). Pyetja nëse Jezusi historik ka përdorur, apo jo, këtë titull dhe nëse e ka përdorur çfarë kuptimi i ka dhënë ai termit në fjalë, ka marrë përgjigje nga më të ndryshmet e imagjinueshme. (Shih W. Kümmel, TRu 45 [1980] 50-84; C.C. Caragounis, The Son of Man [WUNT 39; Tübingen, 1986]) Disa pohojnë se Jezusi e ka përdorur termin “Bir i njeriut” në të tre kuptimet e gjendura në ungjijtë sinoptikë: jeta e hershme ministore, vdekja dhe ringjallja, lartësimi dhe gjykimi i pritshëm. [kështu ka argumentuar O. Cullmann, The Christology of NT [Phl. 1959] 152-64; S. Kim, The “Son of Man” as the Son of God [WUNT 30; Tübingen, 1983]; më i kujdesshëm është treguar Schweizer-i, Jesus 19-21). Disa të tjerë pranojnë si autentike vetëm një apo dy nga këto kuptime. P.sh. JNTT (257-99) pranon vetëm thëniet e mundimeve [passion] dhe lartësimin të Krishtit. A.Higgins (The Son of Man in the Teaching of Jesus [Cambridge, 1980]) pranon vetëm fjalët për të ardhmen, ndonëse si shumë tjerë ai lejon që termi bar (‘e) n?š?’ të kuptohet si “dikush”, “çdokush”, apo thjesht si “njeri” në gjendjen e tij tokësore. R. Fuller (Thomist 48 [1984] 375-376) pranon si të vërteta disa shprehje të tashme dhe të mundimit të Krishtit. Të tjerë akoma si R. Bultmann, (Theology 1. 26-32) dhe H. Tödt (The Son of Man in the Synoptic Tradition [London, 1965]) mbështet idenë se Jezusi e ka përdorur termin “Bir i njeriut” kur i është referuar një figure eskatologjike të ndryshme nga vetja. Gjithsesi, tendenca e ditëve tona është konsiderimi i gjithë këtyre thënieve si ardhura nga aktiviteti midrashik i Kishës së hershme apo nga teologjia e redaktorëve (për një vështrim të përgjithshëm, shih W. Walker, CBQ 45 [1983] 584-607). Një këndvështrim ndërmjetës pohon se Jezusi e ka përdorur termin “Bir i njeriut” jo si një titull, por si një perifrazim, duke ju referuar vetes së tij si anëtarë i një grupi të gjerë ose thjesht si një njeri (Për nuanca të ndryshme: Vermes, Jesus the Jew 160-191; Jesus and the World 89-99; B. Lindars, Jesus Son of Man [GR, 1983]; P. Casey, ExpTim 96 [1985] 233-36). Më pas Kisha e hershme e ka interpretuar këtë term si një titull që i referohet Jezusit gjatë ardhjes së tij të dytë (parousia).

Gjithsesi, në këtë çështje hasen disa probleme të pakalueshme. Nëse, siç supozohet përgjithësisht në ditët tona (kundra A. Higgins), termi “Biri i njeriut” nuk ka ekzistuar si titull në Judaizëm para kohës së Jezusit dhe Kishës së hershme, atëherë çfarë arsye e shtyu Kishën që të shpikte këtë term dhe t’ia vishte atë Jezusit? Përse ky term, në Dhiatën e Re, shfaqet pothuajse gjithnjë në gojën e Jezusit? Përse ky term pasqyrohet në kaq shumë shtresime të traditës ungjillore (traditat e trefishta, të dyfishta, traditat e veçanta për Mateun, për Lukën dhe për Gjonin.), ndërkohë që nuk shfaqen pothuajse asnjëherë jashtë ungjijve? Përse thëniet ku përmendet termi “Bir i njeriut” nuk tregojnë asnjë dallim midis ringjalljes dhe ardhjes së dytë të Jezusit? Ose më specifikisht, përse besimi tek Biri i njeriut nuk shfaqet asnjëherë në kredot e hershme, formulat liturgjike dhe në përmbledhjet e mësimin të krishterë? Asnjë titull tjetër që i është veshur Jezusit nga Kisha e hershme nuk shfaq një histori tradite kaq të çuditshme. Përgjigja e sugjeruar nga W. Ealker nuk i përgjigjet plotësisht këtyre objeksioneve. Mesa

duket shprehjet e veçanta ku përdoret termi “Bir i njeriut”, në një mënyrë apo tjetrën shkojnë deri tek Jezusi, megjithatë një pjesë e mirë e tyre janë zhvilluar nga kishat që erdhën pas tij. Vështirësia me shpjegimin i cili pohon se Jezusi e ka përdorur këtë term me kuptimin e fjalë “unë” ose “një njeri në gjendjen time” qëndron në faktin se nuk kemi prova të qarta që termi bar (‘e n?š?’) ka bartur këtë kuptim në kohën e Jezusit. (Fitzmyer, WA 143-160; J. Donahue, CBQ 48 [1986] 484-98). Është, gjithashtu, e vështirë nxjerrësh kuptimin “një njeri në gjendjen time” prej disa thënieve kur termi “Bir i njeriut” është përdorur për të përshkruar Jezusin tokësorë. Siç është, p.sh., rasti i përshkrimit paralel dypjesësh, që gjendet tek Mateu 11:18-19 dhe pasazhet paralele me të, ku Jezusi dhe Gjon Pagëzori shihen si dy lajmëtarë të urtësisë hyjnore që i ishte dërguar Izraelit. Në këtë rast Jezusi është një figurë specifike, ndërsa një kuptim i përgjithshëm për termin “Bir i njeriut” nuk përshtatet me këtë përshkrim. Shpifja ndaj Jezusit që haset në versetin nr. 19 si edhe dërgimi i tij në një nivel me atë të Gjon pagëzorin e bën të pagjasë faktin që kjo thënie të jetë krijuar nga Kisha. Përse duhet të ketë vendosur Kisha një titull që ka lidhja me ardhjen e dytë të Jezusit në një kontekst ku ai është quajtur grykës dhe pijanec? Siç duket, Jezusi, mjeshtri i parabolave, ka përdorur një përcaktim enigmatik të termit Bir i njeriut për t’iu referuar në mënyrë paradoksale vetes së tij si një i dërguar i ulët dhe famëkeq i Mbretërisë së plotfuqishme të Perëndisë.

Nëse e ka përdorur, apo jo, Jezusi këtë emërtim për të aluduar në përlijjen e tij të ardhshme, duke pasur ndërmend pasazhin e Danielit 7:13-14 (“që i ngjante një Biri njeriu”), është e vështirë për tu thënë. Siç është shprehur edhe Tödt-i (Son of Man 32-112), shprehjet e ngjashme me ato të Markut 8:38 dhe pasazhet paralele të tij, apo me ato të Lukës 12:8-9 ka shumë gjasa të reflektojnë pohimet autentike eskatologjike të Jezusit për Birin e njeriut. Ekzistenca e një figure të tillë apokaliptike nuk mund të provohet se ka ekzistuar në mendimin judaik para ardhjes së Jezusit dhe Jezusi, nga ana e tij, e ka parë veten vetëm si paralajmërues të Perëndisë. Mbi të gjitha, skena e gjyqit përfundimtarë që portretizohet në këto thënie ka përmbledhur të gjithë aktorët e përfshirë në dramën apokaliptike: Zotin, engjëjt, rrëfyesit, mohuesit dhe Birin e njeriut. Në këtë skenë, spikat me mungesën e tij pikërisht Jezusi, kriteri i gjykimit- vetëm nëse Biri i njeriut është vetë Jezusi i përlijtur dhe i lartësuar. Sipas këtij këndvështrimi, Jezusi mund të ketë përdorur termin “Bir i njeriut” në një formë gjëegjëze për të përshkruar pikërisht situatën e tij paradoksale: një profet i cili në gjendjen e tanishme është i ulët dhe vazhdimisht i refuzuar, por të cilit i ishte siguruar përlijja në të ardhmen e afërt. Kjo mund të jetë arsyeja përse termi “Biri i njeriut” nuk haset në thëniet që i përkasin tematikës së Mbretërisë së Perëndisë. Termat “Biri i njeriut” dhe “Mbretëria e Perëndisë” janë dy terma alternativ, “simbole që krijojnë tension” për paradoksin e të qenurit, por ende të mosshfaqurit plotësisht të Mbretërisë së Perëndisë.

Shfaqja e termi “Biri i njeriut” në parashikimet e mundimeve të Jezusit është akoma më problematike. Mungesa e pohimeve të tilla në burimin Q dhe rregullimi skematik i tyre tek Marku kapitulli 8, 9 dhe 10 mund të tregojnë se këtu kemi të bëjmë me një përdorim dytësorë të Birit të njeriut në Kishën e hershme (i këtij mendimi është edhe konservatori E. Stauffer, ANRW II/25.1, 96). Veçanërisht, parashikimi i gjatë që gjendet tek Marku 10:33-34 (e në pasazhet e tjera paralele) duket si një përmbledhje letrare e narrativës së mundimeve të Jezusit që vijojnë më pas në tekstin e tij. Kandidatët më të mundshëm për autenticitet janë pohimet e shkurtra të llojit *m?š?il* që gjenden tek Luka 9:44 (“Biri i njeriut do të bjerë në duart e njerëzve”), Marku 14:41 (“Biri i njeriut po dorëzohet në duart e mëkatarëve”) dhe Marku 14:21 (“Biri i njeriut po shkon ashtu siç është shkruar për të; por mjerë ai njeri me anë të cilit tradhtohet Biri i njeriut. Do të ishte më mirë për të, që ai njeri të mos kishte lindur kurrë!”). Këto thënie nuk i veshin një domethënie eksplicite sotereologjike vdekjes së Jezusit. Ai është thjesht pjesë e misionit të dëshiruar nga Ati. Mbi të gjitha këto thënie mund të reflektojnë një lojë fjalësh

në gjuhën aramaike (Biri i njeriut – bijtë e njeriut). Kjo fjalë lakonike mund të shihet si një shtrirje e thënieve që përdorin termin Bir i njeriut në një kontekst tokësor, duke lëvizur në drejtimin e një predikimi eksplisit të mundimeve (pasionit) të tij. Është i diskutueshëm fakti nëse e ka përdorur, apo jo, Jezusi termin “Biri i njeriut për t’iu referuar afrimit të vdekjes së tij. Është me rëndësi të vërejmë se të tre thëniet ku përdoret termi “Biri i njeriut në” Ungjillin e Gjonit (3:14; 8:28; 12:32-34) flasin për “ngritjen lart” të Jezusit, duke mos dhënë specifikime të mëtejshme për detajet e vdekjes së tij.

## 5. Zot

Nuk ka asnjë problem nëse pohojmë se Jezusi është quajtur Zot gjatë jetës së tij tokësore, nëse marrim parasysh se termi aramaik *mʿr?*, njësoj si termi grek *kyrios*, përmban një spektër të gjerë kuptimesh, të cilat shkojnë që nga shprehja e edukuar “imzot” ose “zotëri” dhe deri tek titulli Zot. (Fitzmyer, WA 115-42; Vermes, Jesus the Jew 103-128). Një gamë e gjerë njerëzish të cilët e kanë takuar Jezusin historik dhe e kanë parë atë në rolin e mësuesit, shëruesit, profetit eskatologjik, apo në atë të një personi që transcendenton këto kategori, mund ti jenë drejtuar atij me termin *mʿr?*. Megjithatë secili prej tyre mund të ketë kuptuar, me këtë term, shkallë të ndryshme nderimi. Ky titull, në këtë mënyrë, siguron një lidhje të gjallë midis rrethit të dishepujve që qëndronin përreth rabinut Jezus të tyre dhe Kishës së hershme e cila adhuronte Zotin e saj të ringjallur.

## 6. Njeriu i shenjtë karizmatik

Një tjetër term i cili lidhet me titujt dhe përcaktimet e trajtuara derimëtanë është edhe ai njeriut të shenjtë hebre (Hasid-it), ose ndryshe njeriut karizmatik, i cili njihej në Palestinë gjatë kohës së Jezusit. Vermes-i (Jesus the Jew 58-85) argumenton se pranë skribëve profesionistë dhe farisenjve të devotshëm kanë ekzistuar edhe disa njerëz të shenjtë – në disa raste me origjinë nga Galilea- të mirënjohur për mrekullitë dhe ekzorcizmat e tyre. Ata ishin më shumë produkt i religjionit tradicional popullor se sa e teologjisë akademike. Ndërmjet tyre ishte edhe Honi Rrethskicuesi (shekulli i parë para erës sonë), i cili praktikisht e detyroi Zotin të sillte shi, duke i kërkuar Atij me ngut njësoj siç i kërkon fëmija të atit. Po ashtu, ndërmjet tyre, ishte edhe Hanina ben Dosa (shekulli i parë i erës sonë), i cili mund të shëronte nga distance, të dëbonte demonët, të kontrollonte natyrën dhe që njihej për varfërinë e tij dhe mungesën e interesit në çështjet ligjore dhe rituale, duke u përqendruar, përkundrazi, në çështjet morale. Duket se ka pasur një lloj tendosjeje midis kësaj figure karizmatike, “çudibërës” njësoj si Elija, me një natyrë tepër individuale dhe me një devotshmëri antikonformiste dhe Judazimit, në zhvillim e sipër, të farisenjve dhe rabinëve. Sidoqoftë, provat për një figurë të tillë karizmatike janë të vonshme dhe janë marrë nga Talmudi dhe Mishna. Kështu që, vlera e tyre për një trajtim kritik të Jezusit historik duhet të mbetet e diskutueshme. Së fundmi, duhet të pohojmë se Jezusi mund të ketë reflektuar një lloj të veçantë devotshmërie popullore galilease e cila në mënyrë të pashmangshme duhet të jetë përplasur me formën më të institucionalizuar të Judaizmit që gjendej në Jeruzalem (shih S. Freyne, Galilee from Alexander the Great to Hadrian [Wilimington, 1980] 329-34; Hengel, Charismatic Leader 44: “karizmatiku eskatologjik”).

Përktheu: Rezart Beka

### Date Created

04/10/2014

### Author

erasmusi